



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:174302

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589469

PPP.nr.185/2

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, të cilin me autorizim e përfaqëson av Burhan Qosa nga Ferizaj, kundër debitorit J.B. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, më datë 18.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit J.B., i ushtruar kundër urdhrit për përmbartim P.nr.432/22, të datës 09.08.2022, të lëshuar nga Përmbartuesi privat B.T. nga Ferizaj, sa i përket kamatës së kërkuar nga i autorizuari i kreditorit prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për përmbartim P.nr.432/22, i datës 09.08.2022, sa i përket kamatës prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim.

II.REFUZOHET prapësimi i debitorit J.B., i ushtruar kundër urdhrit për përmbartim P.nr.432/22, të datës 09.08.2022, të lëshuar nga Përmbartuesi privat B.T., sa i përket shumës së borxhit prej 478.00 euro dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit dhe **MBETET** në fuqi urdhri për përmbartim për shumën e borxhit prej 478.00 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.432/22, të datës 09.08.2022, përmbartuesi privat B.T. e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit N.T., kundër debitorit J.B., për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në shumë prej 478.00 euro, me kamatë prej 8%, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbartim dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit, në bazë të aktvendimit 2019:104036, të datës 16.11.2021, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka

debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të kreditorit ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi si i bazuar.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se:

Prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit në bazë të nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.432/22, i datës 09.08.2022, i lëshuar nga përmbaruesi privat B.T., është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 478.00 euro, dhe për shpenzimet e procedurës së përmbarimit, ndërsa është i paligjshëm sa i përket kamatës së kërkuar nga kreditori me propozim për përmbarim prej 8%, nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbarim.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se: Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin 2019:104036, të datës 19.11.2021, e ka konsideruar se paditësi është tërhequr nga padia me shenjën C.nr.184/2017, me arsyetimin se paditësi gjendet jashtë vendit dhe nuk e ka njoftuar gjykatën se e ka ndërruar vendbanimin siç e parasheh dispozita e nenit 116.1, të LPK-së. Gjykata në arsyetimin e saj ka shkruar se në tabelën e shpalljeve në gjykatë e ka afishuar aktvendimin me ftesën për datën 16.11.2021 por paditësi nuk është paraqitur në gjykatë. Nuk e kam të qartë se nga kush gjykata e morri këtë informacion se unë isha jashtë vendit. Unë jam pensionist nga shteti i Zvicrës por shumicën e kohës e kaloj në fsh ... dhe saktësisht në periudhën nga muaji mars 2021 e deri në fillim të vitit 2022 unë kam qenë në fsh ... dhe nuk e di kush ka mund të deklaroj se në atë periudhë unë nuk pasna qenë në fsh ..., Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit për përmbarim, gjykata nuk ka tagër ta vlerësoj ligjshmërinë e nxjerrjes së aktvendimit 2019:104036, të datës 16.11.2021, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarim i atakuar me prapësim. Për më tepër, për ta vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të cekur më lart është kompetente ekskluzivisht gjykata e shkallës së dytë, gjegjësisht Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës eventuale të palëve ndërgjyqjese. Gjithashtu, gjykata ka për detyrë në këtë rast që duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së urdhrit për përmbarim, konform nenit 43, par 4, të LPP-së.

Përveç tjerash, Gjykata ka konstatuar se aktvendimi 2019:104036, i datës 16.11.2021, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri i atakuar, konsiderohet dokument përmbarimor në bazë të

nenit 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se aktvendimi i cekur më lart, është në tërësi i përshtatshëm për përbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, sepse në aktvendim janë treguar të dhënat e kreditorit dhe debitorit, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit, siç është afati prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. Po ashtu, aktvendimi i cekur është i pajisur edhe me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri, respektivisht i njëjti është i plotfuqishëm nga data 13.07.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.08.2022 dhe kështu në këtë rast janë plotësuar edhe kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së.

Gjykata me rastin e pranimit të prapësimi të debitorit sa i përket kamatës prej 8%, nga dita e dorëzimit të propozimit për përbarim të kreditorit dhe shfuqizimit të urdhrin për përbarim për këtë pjesë, mori për bazë aktvendimin 2019:104036, i datës 16.11.2021, në bazë të cilit gjykata ka konstatuar se në pikën II të aktvendimit në fjalë, është detyruar debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 478,00 euro, por nuk është detyruar që këtë shumë të mjeteve debitori t'ia paguaj edhe me kamatë prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për përbarim. Për më tepër, përbarimi i aktvendimit 2019:104036, i datës 16.11.2021, duhet të caktohet dhe të zbatohet vetëm brenda kufijve dhe shumës së mjeteve e cila është vendosur me aktvendimin e cekur më lart.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
PPP.nr.185/22, më datë 18.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.